



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA JURIDIKE, E KOMUNIKIMIT DHE PROKURIMEVE

**Lënda:** Raport përmbledhës mbi zbatimin e e ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” për vitin 2015

Ministria e Mjedisit ka një praktikë të konsoliduar ndër vite të hartimit të legjislacionit mjedisor në bashkëpunim me shoqatat e mjedisit dhe aktorë të tjerë të interesuar, dhe të konsultimit të tyre me publikun.

Progres Raporti i Bashkimit European për Shqipërinë i vitit 2015, ka bërë një vlerësim pozitiv për punën e Ministrisë së Mjedisit në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe transparencës në vendimmarrje. “Konsultimi me publikun, qasja në informacion dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile janë përmirësuar”. (Progres Raporti 2015, 4.27. Kapitulli për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike, fq. 67).

Ky proces konsultimi dhe organizimi i rregullt i dëgjesave me publikun për legjislacionin mjedisor, planet dhe programet strategjike, është i detyrueshëm prej Konventës së Aarhusit, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar përmes ligjit nr. 8672, datë 26.10.2000, “Për ratifikimin e “Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

Që prej vitit 2006 në Ministrinë e Mjedisit funksionon edhe Qendra e Aarhusit Tiranë, me Pikë Kombëtare Fokale për zbatimin e Konventës së Aarhusit, znj. Edlira Dersha, ([edlira.dersha@moe.gov.al](mailto:edlira.dersha@moe.gov.al)), që mbulon pikërisht detyrat e Kordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik jo vetëm për ligjet dhe strategjitë, por edhe të gjithë aktet e tjera që prodhon Ministria e Mjedisit.

Në mënyrë të rregullt Ministria e Mjedisit njofton organizimin e dëgjesës publike për aktin (ligj ose VKM) që parashikon të dërgojë për mendim në ministritë e linjës, të paktën 15 ditë përpara datës së organizimit të dëgjesës tek një rrjet aktorësh të interesuar, që shkon deri në disa qindra adresa elektronike, dhe në rast Planesh Strategjike ose Strategjive rreth 30 ditë përpara dhe 30 ditë të tjera për komente.

Draft-dokumenti dërgohet gjithmonë elektronikisht tek aktorët e interesuar, të cilët mund të marrin pjesë fizikisht në dëgjesë ose të dërgojnë komentet e tyre me shkrim.

Përveç dërgimit të emailit tek individë, shoqata, autoritete apo ente publike, njoftimi shpallet edhe në faqen zyrtare të ministrisë gjatë gjithë ditëve që i paraprijnë dëgjësës me publikun.

Në përfundim të dëgjësës, brenda 5 ditëve pune, Ministria harton minutat e takimit, të cilat u shpërndahen pjesëmarrësve për komente të mëtejshme, e në vijim publikohen në faqen zyrtare të ministrisë.

Kështu, gjatë vitit 2015, Ministria e Mjedisit ka organizuar 28 dëgjesa me publikun, pa përfshirë disa dhjetëra tryeza të ndryshme konsultative me shoqërinë civile, donatorët, etj, apo aktivitete të tjera ndërgjegjësuere apo konsultuese.

Bashkalidhur këtij Raporti Përmbledhës gjendet lista e plotë e dëgjesave me publikun të organizuara gjatë vitit 2015, duke përfshirë edhe aktet e tjera nënligjore, VKM, etj. që nuk janë pjesë e detyrimeve të ligjit

Ministria e Mjedisit falenderon të gjithë bashkëpunëtorët e saj, grupet e interesit, shoqatat mjedisore, donatorët, etj., të cilët në mënyrë të vazhdueshme i përgjigjen ftesave të saj për pjesëmarrje në Dëgjesat Publike dhe kontribuojnë në procesin e hartimit të legjislacionit mjedisor në Shqipëri.

### **Lista e Dëgjesave me Publikun të organizura gjatë 2015**

1. Dëgjesa publike për projekt-vendimin “Për rregullat, përgjegjësitë dhe procedurat e detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar”; datë 03. 02. 2015;
2. Diskutimi i draft-shtesave dhe ndryshimeve ne Ligjin Nr. 10253, date 11.3.2010 "Per gjuetine" te ndryshuar; datë 16. 02. 2015;
3. Dëgjesa për Draft-Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit 2015 – 2020; datë 31. 03. 2015;
4. Dëgjesa “Për procedurat dhe kërkesat e hollësishme për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet organizatave dhe grupeve, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë me autoritetet përkatëse, që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor”, datë 08. 04. 2015;
5. Dëgjesa “Për rregullat dhe procedura për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”; datë 14. 04. 2015;
6. Dëgjesa “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve; datë 20. 04. 2015;
7. Dëgjesa publike për projektvendimin “Për listën e detajuar të planeve apo programeve me pasojë negative të rëndësishme në mjedis që do t’i nënshtrohen procesit të VSM-së”, datë 23.04.2015;

8. Tryeza për draftin e zonimit të brendshëm të Parkut Kombëtar të Alpeve, në kuadër të hartimit të Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar; datë 23.04.2015;
9. Dëgjesa “Për miratimin e listës së ndotësve organik të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”; datë 05.05.2015;
10. Dëgjesën për projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kërkesave për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit”; datë 08.05.2015;
11. Dëgjesën për projektvendimin «Mbi masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga терминаlet në stacionet e shitjes së karburanteve», datë 20.05.2015;
12. Dëgjesën publike për projektligjin «Për Menaxhimin e Integruar të Kimikateve», datë 16.06.2015;
13. Dëgjesën publike për draft VKM-në “Për shpalljen e ekosistemit natyror detar-bregdetar të Gjirit të Porto Palermos-Llamani zonë të mbrojtur, me status “peizazh i mbrojtur, datë 30.06.2015;
14. Dëgjesën publike për draft VKM-në “Për projektvendimin “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM)”, datë 06.07.2015;
15. Dëgjesën publike për draft ligji “Për administrimin e fondit pyjor dhe kullësor kombëtar në Republikën e Shqipërisë”; datë 08.07.2015
16. Dëgjesën publike për draft VKM “Për tarifat e përdorimit të llojeve të faunës së egër”, datë 10.07.2015;
17. Dëgjesa për draft VKM, “Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve nga operatori”, datë 15.07.2015;
18. Dëgjesa për draft-VKM ”Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t’u konsumuar nga njeriu”, datë 06.08.2015;
19. Dëgjesa për draft-Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan; datë 27.08.2015;
20. Dëgjesa për Hartimin e INDC (Intended Nationally Determined Contribution) - kontributi i synuar kombëtar për minimizimin e emetimeve, datë 14. 08. 2015;
21. Dëgjesa publike për draft-VKM ”Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, datë 11.09.2015;
22. Dëgjesa publike për draft-VKM "Për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Kimikateve", datë 09.10.2015;
23. Dëgjesa publike për draft VKM, “Për miratimin e rregullave të komunikimit,konsultimit dypalësh dhe vendimmarrjes,lidhur me lejen e mjedisit te tipit A, për funksionimin e

instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër ose menjëherë, pasi i kërkohet nga ky shtet”, datë 23.10.2015;

24. Dëgjesa publike për draft Ligjin, “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore industriale, që shkaktohen nga substancat e rrezikshme”, datë 20.10.2015,
25. Dëgjesa publike për draft-VKM për “Mbi kufizimet në prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”, datë 30.10.2015;
26. Dëgjesa publike për draft-VKM për “Importin dhe Eksportin e kimikateve të rrezikshme”, datë 12.11.2015;
27. Dëgjesa publike për draft-VKM “Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (svhc), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e svhc & lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të svhc”, datë 17.11.2015;
28. Dëgjesa publike për Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP), Takimi i V; datë 27. 11. 2015.

Spektori i Transparencës dhe Komunikimit

[info@moe.gov.al](mailto:info@moe.gov.al)